

**MIRATOHET****REKTORI****Akademik Jorgaq KAÇANI**

## **RREGULLORE**

### **PER PROCEDUREN E PRANIMIT TE KANDIDATEVE NE FAKULTETIN E ARKITEKTURES DHE URBANISTIKES PER VITIN AKADEMIK 2014-2015**

Dekanati i Fakultetit te Arkitektures dhe Urbanistikes paraqet Rregulloren per proceduren e pranimit te kandidateve ne degen Arkitekture dhe Urbanistike per vitin akademik 2014-2015.

#### **1. Konsiderata te pergjithshme.**

1.1 Fakulteti i Arkitektures dhe Urbanistikes, (FAU) si shkolla e larte publike me eksperiencen me te gjate ne formimin e arkitekteve dhe urbanistev te rinj, konsideron si element teper te rendesishem kualitetin ne pergatitjen dhe formimin e arkitekteve dhe urbanistev te rinj, i cili fillon nga perzgjedhja dhe seleksionimi i kandidateve.


1.2 FAU, si institucioni pergjegjes per kualitetin e arkitekteve dhe urbanistev te rinj, duhet detyrimisht te ushtroje pergjegjesite e veta qysh ne perzgjedhjen e kandidateve ne pranimin e tyre ne fakultet.

1.3 FAU, si shkolla e larte publike me eksperiencen me te gjate ne formimin e arkitekteve dhe urbanistev te rinj, ka kapacitetet e nevojshme per perzgjedhjen profesionale te kandidateve qe do te pranohen ne kete shkolle.

1.4 Forma e perzgjedhjes se kandidateve pasqyron eksperiencen e deritanishme tek ne dhe te shkollave homologe evropiane me specifikat e tyre te vecanta, si dhe ligjet e

rregulloret e MAS ne perzgjedhjen e studenteve sipas parimit Merite-Preference te Matures Shteterore.

1.5 Bllok-skema e realizimit te perzgjedhjes se kandidateve per te vazhduar studimet ne FAU tregohet si me poshte vijon:



## 2. Perzgjedhja fillestare e kandidateve.

2.1 Perzgjedhja fillestare e kandidateve behet nga MAS, sipas parimit Merite-Preference mbi bazen e Matures Shteterore dhe koeficienteve per cdo lende.

2.2 Percaktimi i koeficienteve te lendeve te Matures Shteterore behet cdo vit nga UPT me propozimin e FAU, duke i dhene preference lendeve te shkencave ekzakte dhe inxhinierike. Koeficientet behen publike nga MAS nepermjet Matures Shteterore.

2.3 Kuotat e perzgjedhjes fillestare te kandidateve propozohen nga FAU, miratohen nga UPT dhe mbi bazen e tyre behet pecaktimi definitiv i kuotave nga MAS. Per vitin 2014-2015 kuotat e perzgjedhjes fillestare te propozuara nag FAU-UPT jane ne total **220** kuota, nga te cilat **135** kuota ne programin e studimit **Arkitekture** dhe **85** kuota ne programin e studimit **Urbanistike**.

### **3. Rregjistrimi ne vitin e pare te studimeve.**

3.1 Kandidatet e perzgjedhur nga MAS nepermjet Matures Shteterore ne programet e studimit Arkitekture dhe Urbanistike, sipas pikes 2, fitojne te drejten te rregjistrohen ne vitin e pare ne programet perkatese te studimeve Arkitekture ose Urbanistike, mbi bazen e rregullores se percaktuar nga MAS.

3.2 FAU, ben publik planet dhe programet mesimore per vitin e pare te studimeve ne programet e studimit Arkitekture dhe Urbanistike si dhe Rregulloren e procedures se pranimit ne FAU. Sekretaria mesimore e FAU pajis cdo kandidat te rregjistruar me dokumentin perkates te rregjistrimit, planin perkates te studimeve per vitin e pare si dhe rregulloren e procedures se pranimit ne FAU.

### **4. Realizimi dhe vleresimi i studimeve te vitit te pare.**

4.1 Kandidatet e rregjistruar ne vitin e pare ne programin perkates te studimeve Arkitekture ose Urbanistike jane te detyruar te ndjekin rregullisht studimet sipas planit dhe programit perkates, duke respektuar te gjitha detyrimet qe rrjedhin konform rregullores se MAS per shkollat e larta dhe rregullores se UPT.

4.2 Realizimi i studimeve te vitit te pare konsiston ne realizimin e te gjitha detyrimeve dhe proves finale per secilen lende sipas programit te studimeve.

4.3 Dekanati i FAU monitoron te gjithe procesin e realizimit te studimeve te vitit te pare si dhe provat finale ne secilen lende.

4.4 Prova finale vleresohet nga nje komision i perbere nga minimumi 5 pedagoge per lendet profesionale dhe minimumi 2 pedagoge per lendet me karakter te pergjithshem. Vleresimi i tyre perfundimtar eshte 0-10 pike dhe rezultati final eshte mesatarja aritmetike e vleresimit te te gjithe anetareve te komisionit.

4.5 Menyra e vleresimit të secilës lende konsiston në realizimin e pjesëmarrjes në mesim përmes vleresimit me kredite ECTS, për secilën lende, si dhe Notes Perfundimtare që vlerëson kualitetin e përvetësimit të dijeve për secilën lende. Nota Perfundimtare (0-10) është shumatore e elementeve përberës, të përcaktuara në programin e detajuar të secilës lende.

4.6 Për secilin nga kandidatët llogaritet mesatarja e ponderuar, e cila merr për bazë kreditet e realizuara dhe notën perfundimtare në secilën lende. Llogaritja e mesatares së ponderuar për secilin kandidat llogaritet sipas formulës së mëposhtme:

$$MES_{\text{ponderuar}} = \frac{\sum_{i=1}^n [NotaP(i) * ECTS(i)]}{\sum_{i=1}^n ECTS(i)}$$

Ku:

- **MES<sub>ponderuar</sub>** – mesatarja e ponderuar për kandidatin
- **n** – numri total i lendeve të programit mesimor të vitit të parë
- **i** – indeksi i lendes.
- **NotaP(i)** – Nota perfundimtare në lenden me indeksin përkatës
- **ECTS(i)** – Kreditet për lenden me indeksin përkatës.

4.7 Nëse në listën e lendeve të programit mesimor rezultojnë lende të pashlyera, për efekt llogaritje të mesatares së ponderuar, nota perfundimtare e tyre vlerësohet me note negative, NotaP(i)=0.

4.8 Në fund të sezonit të provimeve vjeshtës, Sekretaria Mesimore e FAU, afishon listën e kandidatëve sipas programeve të studimit, me mesataren e ponderuar dhe kreditet e realizuara nga secili kandidat.

## 5. Perzgjedhja perfundimtare e kandidatëve.

5.1 Perzgjedhja e kandidatëve për në programet e studimit Arkitekture dhe Urbanistike të FAU bëhet me mbylljen e vitit të parë të studimeve, menjëherë pas sezonit të provimeve të vjeshtës.

5.2 Fitojnë të drejtën e perzgjedhjes perfundimtare të gjithë ata kandidatë që kanë realizuar në total minimumi 30 ECTS, sipas rregullores së studimeve të UPT sipas Sistemit të Bolonjes.

5.3 Kandidatet që kanë plotësuar numrin minimal të krediteve (30 ECTS) në programin përkatës të studimeve renditen në liste sipas mesatares së ponderuar.

5.4 Pas përfundimit të vitit të parë të studimeve, fitojnë të drejtën e përzgjedhjes përfundimtare për të vazhduar vitin e dytë të studimeve kandidatët që përfshihen brenda **80%** të listës së renditur të kandidatëve në programin përkatës të studimeve, përkatësisht:

- Programi i studimeve **Arkitekture**  
 $135\text{kuota} * 80\% = 108\text{kuota}$ . Fitojnë të drejtën përfundimtare 108 kandidatët e renditur të parët në listën e programit të studimeve Arkitekture.
- Programi i studimeve **Urbanistike**  
 $85\text{kuota} * 80\% = 68\text{kuota}$ . Fitojnë të drejtën përfundimtare 68 kandidatët e renditur të parët në listën e programit të studimeve Urbanistike.

## 6. Kandidatet jashtë përzgjedhjes përfundimtare.

6.1 Kandidatët që kanë fituar mbi 30 ECTS dhe kanë mbetur jashtë përzgjedhjes, transferojnë studimet automatikisht në vitin e dytë të programit të ri të studimeve të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, BACHELOR në Arkitekture Interieri dhe Dizajn (BAID).

6.2 Kandidatët që nuk kanë fituar 30 ECTS në vitin e parë, transferojnë studimet automatikisht në vitin e parë të programit të ri të studimeve të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, BACHELOR në Arkitekture Interieri dhe Dizajn (BAID).

DEKANI

i Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës

**Prof.Dr. Andrea MALIQARI**